


FAKTE STATISTIKORE

MBI TURIZMIN NË MAQEDONINË E VERIUT


ARDHJET E TURISTËVE DHE NETËT TURISTIKE TË KALUARA



Në vitin 2020 u shënuar rënie e konsiderueshme **(-47.97%)** për shkak të pandemisë së COVID-19.

Në vitin 2021 u shënuar rritje prej **36.29%** dhe **23.13%** në 2022.

KRAHASIMI I TURISTËVE VENDOR DHE TË HUAJ



Pjesëmarrja e turistëve vendas ka rënë nga **49.43%** në 2011 në **44.55%** në 2022.


Pjesëmarrja e turistëve të huaj është rritur nga **50.57%** në 2011 në **55.45%** në 2022.

KRAHASIMI I TURISTËVE VENDOR DHE TË HUAJ PËR VITIN 2022




Në vitin 2022, numri total i turistëve ka arritur në **969,277**, ndërsa numri total i netëve të kaluara ka arritur në **2,848,604**. Kjo tregon një rritje prej **23.13%** krahasuar me vitin e kaluar.

SHTETET NGA KU KANË ARDHUR MË SË SHUMTI TURISTË NË MAQEDONINË E VERIUT PËR VITIN 2022




Në vitin 2022, 10 shtetet nga ku kanë ardhur më së shumti turistë në Maqedoninë e Veriut janë: Turqia (**79,927**), Serbia (**63,834**), Greqia (**29,918**), Gjermania (**27,826**), Bullgaria (**25,600**), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (**23,372**), Polonia (**23,150**), Kosova (**21,274**), Shqipëria (**20,738**) dhe Holanda (**19,853**).

NUMRI I PËRGJITHSHËM I TURISTËVE QË KANË VIZITUAR OHRIN DHE STRUGËN, 2011-2022




Në vitin 2022, Ohri ka tërhequr **283,270** turistë, ndërsa Struga **78,844** turistë. Në vitin 2011, pjesëmarrja e turistëve në Ohër ishte **75.11%**, ndërsa në Strugë ishte **24.89%**. Kjo pjesëmarrje ka ndryshuar pak në vitin 2022, ku Ohri ka përfshirë **78.23%** të turistëve dhe Struga **21.77%**.


PËRQINDJA E TURISTËVE NË STRUGË VS. NË OHËR, 2011



PËRQINDJA E TURISTËVE NË STRUGË VS. NË OHËR, 2022





KAPACITETET HOTILERIKE SIPAS KATEGORIVE, 2011 VS 2022



Numri i dhomave në hotele me 5 yje ka rritur me **156.42%**, ndërsa në hotele me 4 yje ka rritur me **143.46%**. Ndërkohë, hotelet me 1 yll kanë parë një rënie të madhe prej **44.73%**.

NUMRI I TURISTËVE SIPAS REGJIONIT, 2011 VS 2022



Numri i turistëve është rritur në të gjitha regjionet e Maqedonisë së Veriut midis viteve 2011 dhe 2022, me përjashtim të regjionit të Pellagonisë ku ka pasur një rënie prej **33.95%**. Rritja më e madhe është shënuar në regjionin Verilindor me **174.26%**, ndërsa regjioni Jugperendimor, që përfshin destinacionet kryesore turistike si Ohri dhe Struga, ka shënuar rritje prej **51.44%**.